REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë/Datum/Date:	12.01.2023
Për/Za/To:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkryetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Shkelzen Hajdini – Drejtor i DSHPS –së
Lënda/Subjecat/Subject:	Raport Mujor – Dhjetor 2022

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur ju lutem gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për periudhën 01.12.2022 deri 31.12.2022.

RAPORT MUJOR PËR MUAJIN NËNTOR 2022

1. Përmbledhje ekzekutive

Ne muajin dhjetor 2022 kemi filluar te i korrim te gjitha investimet dhe mundin qe kemi bere duke përfshire, por duke mos u limituar, si:

- Avancimin e mëtutjeshëm te shërbimeve shëndetësore duke filluar me implementimin e konceptit te mjekësisë familjare,
- Avancimin e mëtutjeshëm te shërbimeve shëndetësore ne mjekësinë familjare përmes ngritjes se vazhdueshme te kapaciteteve te personelit mjekësor,
- Avancimin e shërbimeve laboratorike duke bere rritjen e numrit te analizave te ofruara dhe shkurtimin e kohës për ofrim te analizave,
- Shkurtimin e kohës se pritjes ne shërbimin e radiologjisë diagnostike,
- Rritjen e numrit te shërbimeve ne stomatologjike dhe rritjen e sigurisë gjate ofrimitte shërbimeve,
- Rritjen e shërbimeve dhe vizitave për nenat ne sektorin e maternitetit dhe gjinekologjisë
- Avancimin dhe përmirësimin e kushteve ne QMF te vendosura ne fshatra,
- Përmirësimin e higjienës dhe avancimin e mirëmbajtjes ne QKMF, etj.

2. Punët dhe aktivitetet e realizuara bazuar në Planit e Punës së DHSPS-së për vitin 2022

Problemet me rëntgenin e vjetër analog kane marre fund. Rëntgeni digjital është vendosur ne objektin e pulmologjisë dhe është lëshuar ne funksion. Ashtu siç është premtuar, ne shërbimin radiologjisë nuk ka me pritje ne rend. Ne Shërbimin e Radiologjisë Diagnostike në QKMF do të kemi mundësi te ofrojmë teste radiologjike specialistike me kërkesë të mjekëve familjar, pediatrit, stomatologeve dhe mjekëve te profileve tjera shëndetësore dhe nuk do te krijohen radhe te pritjes.

Sektori i Stomatologjisë është fuqizuar duke avancuar kushtet punës, pajisur me te gjitha aparaturat dhe pajisjet e nevojshme pe ofrim te shërbimeve te mirëfillta dhe te sigurta stomatologjike.
dhe është përgatitur për ofrimin e te gjitha shërbimeve te përcaktuara me ligjin për shëndetësinë dhe shërbimet qe duhet te ofrohen ne kujdesin parësor shëndetësor duke filluar nga rentgeni i dhëmbit, shërimi, mbushja e deri te nxjerrja e dhëmbit..

Shërbimi i urgjencës është përgatitur për fluksin e madh te pacienteve gjate festave te fund vitit duke rishikuar orarin e punës dhe vendosjen e numrit te mjaftueshëm te personelit shëndetësor si dhe duke u inspektuar dhe servisuar automjetet, aparaturat dhe pajisjet për shërbime të shpejta.

Shërbimi i laboratorit është furnizuar me aparat te ri biokimik, numërues hematologjik dhe pajisje e aparatura tjera te nevojshme dhe jemi duke ofruar 38 parametra/analiza siç specifikohet me ligj. Kjo vlenë për QKMF dhe te gjitha QMF - të në fshatra.

Në kuadër të fuqizimit të QMFve, QMF-te do te pajisen me numërues hematologjik dha pajisje te nevojshme laboratorike. .

Gjatë muajit Dhjetor nuk ka pase numër te madh të rasteve me Covid-19. Kemi vazhduar me masat e rekomanduara nga MSH dhe IKSPK për pandeminë Covid-19. Vaksinimi me vaksinën anti-Covid ka vazhduar për çdo ditë pune në ndarjen e adaptuar në QKMF.

Furnizimi me barna esenciale dhe material mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë nuk ka qene I plotë dhe është përcjellur me mungesa të mëdha.

Renovimi i QMF-së në Gadime është duke vazhduar. Sipas menaxherit të kontratës dhe AQH-së punimet janë duke vazhduar me dinamiken e paraparë. AMF në babush me sukses është duke i ofruar sërbimet e QMF-së në Gadime.

Furnizimi i institucioneve shëndetësore në Lipjan nga barnatorija e QKMF-së në Lipjan me barna, material stomatologjik, laboratorik dhe material tjetër është bërë me rregull.

Është bërë shënimi i muajit Dhjetor me ligjërata për vizitat në shtepi për nëna dhe femijë deri në 3 vjeç, Janë realizuar dhjetë (10) ligjërata në komunitet, të përkrahura nga AMC.

3. Vaksinimi i rregullt dhe kundër Covid19

Gjatë muajt Dhjetor nuk eshte vaksinuar asnje qytetar.

4. Testimet kundër Covid19

Numri i rasteve të infektuar me virusin Sars-Cov-2 (Covid-19) ka shënuar ulje gjatë muajit Nëntor2022.
Numri i përgjithshëm i tesimeve në muajin Nentor 2022 ka qenë 27 të testuar. Tri raste kane rezultuar pozitiv.

5. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulata të Mjekësisë Familjare (AMF) gjatë muajit Nentorjanë kryer gjithsejtë 34508 vizita dhe shërbime shëndetësore.

Dhjetor 2022, Vizitat Mjekësore

1	Vizita mjekësore nga Mjekësia Familjare në QKMF	7716
2	Vizita mjekësore nga Mjekësia Familjare-Punkte	3781
3	Vizita mjekësore Pediatrike	467
4	Vizita mjekësore Gjinekologjike	442
5	Vizita Stomatologjike	728
6	Vizita Pulmologjike	40

7	Vizita mjekësore në shërbimin e Urgjencës në QKMF	3961
8	Vizizita në kujdrsin Paliativ	117
9	Total	17252

Shërbime tjera Shëndetësore

1	Inekcjone	7320
2	Infuzjone	2683
3	Pastrim lidhje plagësh	1156
4	RTG	121
5	Laborator	1912
6	Lindje	1
7	Largim I Penjëve	78
8	Imobilizime	29
9	Oksigjeno-terapi	47
10	EKG	651
11	Mamografi	0
12	USG	109
13	Viz. Shte.me Autoambulanc	56
14	Trasferim me Autoambulanc	81
15	Vizit në Stacionin Policor	0
16	Vizit në Qendren e azilit -Magure	2
17	Inte. ne qendren e paraburgimit	6
18	Rrahje	6
19	Këmbsor I lenduar me automjet	0
20	Konstatim vdekje	6
21	Plagosje me arm zjarri	0
22	Thumbim i rriqnave	7
23	Aksident trafiku	25
24	Dhunë familjare	1
25	Exitus letalis / mortus ad latae	0
26	Këshillimorja	78
27	Vakcina	1470
28	Vaksina për COVID	4
29	Teste Rapide	27
30	Referime	1380
31	Inhalime	61
32	Vizita infermiere gjinekologjike	132
33	Vizita për nëna dhe fëmijë 0-3 vjet	168
34	Klasa për nëna	31
33	Gjithsej sherbime	17256

6. Qendra për Punë Sociale QPS

Tabela 1. Shërbimi Social: Shërbimet dhe klientët.

Klientët	Numri i rasteve	Shërbimet	Numri i rasteve
Fëmijë me sjellje asociale	3	*Kujdestaria*	/
Të mitur në konflikt me. ligjin	18	*Përfaqësues të përkohshëm*	
Kujdestari për fëmijet e pa shoqëruar	/	*Këshillim për bashkshort në martesë*	7
Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e detyrës prindrore	/	*Sanim i marrëdhenieve familjare*	/
Klient me aftësi të kufizuar Fëmijët	/	*Besim i femijeve dhe mbikqyerje e vizitave prindërore*	2
Klientë në nevojë për kshillime	/	*Ndimë materiale për fëmijët me aftësi të kufizuar*	/
Klient tjerë në nevojë për shërbime	63	*Shërbime për të rritur me AK.*	/
Klient me aftësi të kufizuar – Fëmijët	2	*Shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuar*	65
Viktima të vendosura në strehimore	/	*Shërbime për të miturit në konflikt me ligjin*	18
Viktimat e krimeve seksuale	/	*Këshilla psiko-sociale*	4
Viktimat e dhunës në familje	9	*Intervenim i viktimave*	9
Fëmijë të keqtrajtuar-abuzuar (lënë pas dore)	/	*Intervenim I viktimave gjatë kujdestarisë*	7
Të moshuarit në nevojë për shërbime	/	*Intervenimet e përgjithëshme*	163
Nr. I Përgjithshëm I klientëve	95	*Numri i përgjithshëm i shërbimeve*	275

Tabela 2. Shërbimet e asistencës sociale.

	Aktivitetet	**Kategoria 1**	**Kategoria 2**	**Gjithsej**
APLIKIMI	1.Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë.	**6**	**3**	**9**
	Sa prej tyre janë të aprovuara	**1**	**2**	**3**
	Sa janë në shqyrtim	**0**	**0**	**0**
	Sa prej tyre janë të refuzuara	**5**	**1**	**6**

RIAPLIKIMI	2. Numri i rasteve të larguara për mos ri-aplikim.	**5**	**6**	**11**
	2.1 Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar.	**26**	**31**	**57**
	2.2 Numri i rasteve të larguar për mungesë të dokumentacioni.	**0**	**0**	**0**
VERIFIKIMI	3.Numri total i familjeve të verifikuara/ri-verifikuara	**30**	**40**	**70**
	Sa prej tyre janë aprovuar Koliko od njih je odobreno	**26**	**31**	**57**
	Sa prej tyrjanërefuzuar/çregjistruar	**4**	**9**	**13**
KOM.	4. Numri i rasteve të dërguara. në Komision Mjekësor (KM)	**56**	**0**	**56**
	Numri i rasteve të aprovuara nga KM	**19**	**0**	**19**
	Numri i rasteve të refuzuara nga KM.	**35**	**0**	**35**
	Numri i rasteve të kthyra nga KM për kompletim dokumentacioni	**2**	**0**	**2**
	3.Numri i ankesave të paraqitura nga Shfrytëzuesit	**3**	**0**	**3**
	A. Në shkallë të parë(I) Na prvi stepen (I)	**3**	**0**	**3**
	B. Në shkallë të dytë(II) Na drugi stepen (II)	**0**	**0**	**0**
	Numri i ankesave të aprovuara	**0**	**0**	**0**
	Numri i ankesave të refuzuara	**0**	**0**	**0**

	Numri i ankesave në shqyrtim	**0**	**0**	**0**
	Kontestet në Gjykata	**0**	**0**	**0**
	a) Kontestet të pranuara	**0**	**0**	**0**
	b)Konteste të refuzuara	**0**	**0**	**0**

Gjatë kësaj periudhe Qendra për Punë Sociale është përballur me mungesë të stafit për shkak të mos plotësimit të pozitave të lira në të dy sektorët.

7. Shtëpia me Bazë në Komunitet

Gjendja e përgjithshme ka qenë e mirë, nuk kemi pas ndonjë problem apo vështërsi. Gjendja shëndetësore e rezidentëve gjatë keti muaji në përgjithësi ka qenë e mirë, rezidentët kanë pasur disa probleme të vogla shëndetësore të cilat shumicën e rasteve janë administraur nga stafi i shtëpisë dhe në disa raste kemi kërkuar ndihmen nga QKMF-Emergjenca në Lipjan dhe QKUK.

8. Investimet Kapitale

Renovimi i tualeteve në QKMF, është realizuar pjeserishte.

Eshte realizuar dhe eshte bërë liferimi aparaturave mjekesore si pjesë e projektit Blerja e Aparaturave Mjekësore.

Renovimin e QMF-së në Gadime.

9. Vështërsitë dhe sfidat

- Ngecja e punimve nga operatoret ekonomik në QKMF ka qenë e vështirësuar dukshëm.
- Furnizimi i pjesërishëm me barna dhe materiale mjekësore nga M.Sh. (mungesa e terapisë orale disa lloje të barnave anti hipertensive)
- Renovimt të QMF-Gadime
- Mungesa e automjeteve të përshtatshme për bartjen e pacienteve me dializë.
- Mungesa e automjetit për këshillimore dhe programin kujdesi ndaj fëmijëve dhe nënave.

10. Planifikimi për muajin Janar 2022

- Monitorimi i zbatimit të pakos esenciale për menaxhimin e semundjeve kronike jongjitëse si: diabeti, hipertensioni dhe astma.

- Vazhdimi i zbatimit të masave për parandalimin e epidemisë me COVID 19.
- Vazhdimi i implementimit të projektit me AQH-në për Qendër Demostruese QKMF, QMF-Gadime dhe AMF-Kraishtë. Takime konsultative dhe trajnime të stafit për pilot Projektin ne Telemjekësi dhe Menaxhim të cilësisë.
- Zbatimi i planit të veprimit për vaksinimin me vaksinat anti-Covid-19.
- Vazhdimi i kërkesave për inicimin e proceduarve të prokurimit sipas planit të realizimit të projekteve për vitin 2023.